

PROCESVERBAL
nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 26.6.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 13:45 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.6 2023.
2. Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion Këshillit të Shoqatës për Etikë në Media të Maqedonisë ETIKA PRES Shkup për mundësimin e funksionimit pa pengesë të Zyrës Ekzekutive dhe Komisionit për Ankesa dhe Propozim-kontratë për donacion.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski, për arsye teknike e anuloi miratimin e Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.6.2023, për para fillimit të seancës së ardhshme.

Pika 2

Z. Trajçevski arsyetoi Propozim-vendimin për dhënien e ndihmës financiare - donacion Këshillit të Shoqatës për Etikë në Media të Maqedonisë ETIKA PRES Shkup për të mundësuar funksionimin pa pengesë të Zyrës Ekzekutive dhe Komisionit për Ankesa me Propozim – kontratë për donacion. Ai sqaroi se kjo pikë vjen pas Vendimit për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për vitin 2023, i cili është miratuar në seancën e kaluar. Është propozura ndarja e mjeteve financiare në shumë prej 300.000,00 denarë.

Z. Fidanoski deklaroi se do ta përkrahë propozimin sepse është imendimit se duhet t'i jipet ndihmë këtij trupi vetërregullues. Ai shpjegoi se vetërregullimi është segment shumë i rëndësishëm në hapësirën mediatike në Maqedoni. Sa më shumë të përhapet dhe sa më shumë të praktikohet, aq më shumë profesionalizmi dhe liria e shprehjes janë në nivel më të lartë. Agjencia si trup rregullator dhe ata vetë si rregullator i referohen njëri-tjetrit, kanë vite që bashkëpunojnë dhe ky bashkëpunim është i suksesshëm. Ai bën të ditur se ky është një nga themeluesit e këtij trupi që para 10 vitesh dhe ajo për të cilën shpreh keqardhje është se ky trup nuk ka mundur të gjejë burim të qëndrueshëm financimi. Shumë punë të tjera në shtet funksionojnë përmes bazës së projekteve dhe duke njohur procedurën burokratike për marrjen e një projekti, në fillim shfaqen hapësira të tilla vakumi, për të cilat ai shpreson se në të ardhmen do të jenë më të vogla ose nuk do të ekzistojnë fare. Shpreson se Këshilli i Shoqatës për Etikë në Mediale të Maqedonisë do të ketë sukses në një moment për një të ardhme sa më të afërt të jetë në mesin e këtyre trupave vetërregullues që kanë burime të përhershme dhe të qëndrueshme financiare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Shoqatën e Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë ETIKA PRES Shkup, në shumë prej 300.000,00 (treqind mijë) denarë, me qëllim të funksionimit pa pengesë si trup i vetëm vetërregullator për mediat në vend, deri në fillimin e projekteve me Zyrën Rajonale të UNESCO-s dhe Fondacionit Blankuerna – Spanjë.

Mjetet financiare janë të parapara në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 dhe të njëjtat lëshohen në llogarinë e Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë: 210-0693808601-77, depozitues i NLB Bankë SHA Shkup, me numër tatimor 4080014542793.

Për ndihmën financiare të dhënë-donacion nga Vendimi i mësipërm, është lidhur Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë, i cila do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-2576/3

12.07.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**